

DEMOKRACIA ERDHI NË JETËT TONA



PO SIKUR PRANVERA

KONTRIBUTI I FËMIJËVE NË DEMOKRACI

SEKINE (11), SARA (10), ELISA (11), OLTA (10), YLLKË (11), SENA (11), ENES (10), ALTIN (10), LIS (11),
ERON (10), TOMORR (11)



Unë, shokët e mi dhe të gjithë qytetarët e këtij shteti i japim kuptim më të gjerë demokracisë

Të gjithë e dijmë se demokracia dhe filltet e saj datojnë qysh nga kohët e lashta. Vlera dhe rëndësia e saj ndër vite veçse rritet, ashtu siç rritet edhe vullneti i qytetarëve që këtë sistem të qeverisjes ta kenë përherë. Themi kështu, sepse demokracia është sistem në të cilën populli është ai i cili i zgjedh përfaqësuesit e vet. Pra, peshë dhe roli që ka populli në demokraci nuk mund të maten.

Nga nëntitulli mund të kuptoni që artikulli ynë do të jetë më i fokusuar tek qytetarët, duke më përfshirë këtu edhe mua. Vetë kuptimi i fjalës demokraci është udhëheqje nga populli, që nënkupton se është populli ai i cili udhëheq. Pjesë e popullit është çdo qytetar i vendit tonë, pa dallime feje, race, kombi, etj. Demokracia nuk njeh dallime. Nuk është si në të kaluarën, kur shumica e qytetarëve ishin të diskriminuar. Tani të gjithë trajtohen në mënyrë të barabartë.

Kthehem përsëri tek rëndësia e qytetarëve në demokraci, si dhe cili tek ndikimi i tyre në këtë sistem. Unë Eroni edhe pse jam shumë i ri në moshë, jap kontribut të madh për këtë sistem. Këtë e bëj duke i vënë në funksion shumicën e elementeve të demokracisë. Unë respektoj mendimet e të tjerëve, jam dhe tregohem shumë tolerant në situata të ndryshme, si dhe e shoh veten të barabartë me secilin prej njerëzve që unë i njoh. Ndoshta për dikë, ato që sapo i ceka nuk janë

shumë të rëndësishme, mirëpo, për mua si nxënës kjo do të thotë shumë. Sot sillem kështu, por në të ardhmen kontributi im do të jetë shumë herë më i madh. Këto që i thashë për vete, vlejné për të gjithë shokët dhe shoqet e mia.

Të gjitha elementet që i kemi cekur në artikull i kemi mësuar në shkollë, vendi të cilin ne nxënësit e klasës sonë e quajmë „foleja e dijes“.


Në këtë institucion kemi mësuar se demokracia ka lindur në Athinë në vitin 507 p.e.s., ku atëherë u shfaq si demokraci e drejtpërdrejtë. Kurse, tash ekziston edhe ajo përfaqësuese. Këtë të fundit e ka vendi ynë, Kosova. Përfaqësuesit fuqinë e marrin nga populli. Për këtë, kur duhet të marrim vendime në emër të popullit ata mendojnë shumë gjatë. Pra, nuk jemi vetëm unë dhe shokët e mi ata që kontibuojmë për demokracinë e vendit tonë, janë të gjithë qytetarët. E këtu bëni pjesë edhe ju të dashur lexues.



Gazetarët demokratë

ROLI I KUVENDIT NË JETËN TONË

SUELA (11), ARTI (11), BELINA (10), ARI (11), ELSA (10), FIONA (10), VLERA (11), ENDRIT (11),
GJYLSIME (11) , REJON (10), RIONA (10)



Kuvendi, institucioni më i lartë ligjvënës

Ligjet, rregulla të cilat duhet t'i respektojmë dhe t'i zbatojmë. A thua vallë, nga kush dhe ku merren vendimet për këto ligje? Deputetët, të cilët i zgjedh populli me vota, i miratojnë këto ligje në Kuvend. Kuvendi njihet ndryshe edhe si „Shtëpia e Popullit“.

Në Kuvendin e Kosovës janë gjithsej 120 deputetë, 100 prej tyre janë të kombit shqiptar, kurse 20 të tjerë janë të komuniteteve jo shumicë, si serbë, romë, ashkali, egjiptianë, boshnjakë, turq dhe goranë. Kuvendi është institucion ligjvënës, sepse deputetët kanë të drejtë të propozojnë ligje, si dhe t'i miratojnë ato me anë të votave. Të gjitha të drejtat i kemi të garantuara pikërisht me ligj. Në vijim do ta tregojmë një shembull se si ne fëmijët jemi të lirë dhe kemi shumë të drejta në demokraci.

Kaloi dimri dhe erdhi pranvera. Gjatë kësaj stine, ne fëmijët luajmë shumë shpesh. Sa jemi të lumtur dhe të sigurt që kemi një shtet demokratik. Kur dalim në lagjen tonë, kemi të drejtë të luajmë lojëra të cilat neve na pëlqejnë. Për shembull, basketboll, futboll, volejball, etj. Përveç lojërave, ne fëmijët kemi të drejta të tjera si: të drejtën e shkollimit, të drejtën e argëtimit, të drejtën për t'u shprehur lirshëm, etj.

Pra, duke pasur parasysh që në Kuvend merren vendimet për ligjet, të cilat i garantojnë këto të drejta që i kemi, roli i këtij institucioni demokratik është shumë i rëndësishëm në jetën tonë. Por, ne duhet të jemi shumë të përgjegjshëm si qytetarë, sepse çdo sjellje e jona ndikon në jetën tonë. Fëmijët janë e ardhmja e vendit. Prandaj, duhet të mësojmë dhe të përkushtohemi shumë në punët tona.




Vendi i ligjeve



Grupi „Kristalet“

INFORMATAT PËR DEMOKRACI, I GJENI KËTU

RINESA (10), SHAHIN (10), ELONA (10), ENET (10), VESA (11), ENGJËLL (10), NESA (10), ALI (10),
AGNESA (10), GENT (11), ARISA (10)



Ekziston media e shkruar dhe ajo elektronike. Kurse sot ne do të jemi pjesë e medias së shkruar

Që nga mosha parashkollore, prindërit tanë janë përpjekur që të na mësojnë shkronjat me anë të këngëve. Por kur hymë në klasë të parë, mësuesja filloi të na mësojë simbolet e shkronjave në mënyrë që përmes

tjera interesante.

Ne sot, po punojmë për një gazetë, gazetë kjo e cila është e punuar me shumë dashuri dhe përkushtim. Gazetat, por edhe mjetet e tjera informuese siç janë: revistat, librat, etj, hyjnë tek media e shkruar. Përveç medias së shkruar, kemi edhe median elektronike e cila përfshin: radion, televizionin, kompjuterin, telefonin, internetin, etj.

Ne jemi shumë të lumtur që na u dha kjo mundësi sot, që të tregojmë talentin tonë gazetaresk dhe aftësitë tona për vizatim. Ashtu siç e shfrytëzuan ne të drejtën për t'i informuar qytetarët, urojmë që edhe të tjerët t'i shfrytëzojnë të drejtat e tyre të cilat na i ofron vetëm kjo formë e qeverisjes, e quajtur demokraci.



tyre t'i kuptojmë se si duken ato.

Çdo ditë e më tepër, u angazhuam që të shkruajmë sa më mirë e me sa më pak gabime. Kjo na bëri të zotët që ne sot këtu në „Demos-ti“, të bëhemi gazetarë dhe të shkruajmë një artikull të tërë.

Të jesh një gazetar është kënaqësi e madhe, e sidomos në një shtet demokratik siç është Kosova. E themi këtë, sepse në demokraci të gjithë qytetarët kanë të drejtë ta ushtrojnë profesionin e tyre të zemrës lirishtëm. Edhe gazetarët kanë të drejtë që t'i informojnë qytetarët për ndodhi të ndryshme e për shumë gjëra të



Gazetarë të medias së shkruar

Po e vazhdojmë këtë artikull, të cilin e filluam duke shkruajtur për median dhe po e përmbyllim duke shkruajtur për zgjedhjet në jetën e përditshme, si dhe për procesin zgjedhor, i cili zhvillohet në shtetet demokratike



Edhe pse kërkesat dhe preferencat tona janë të ndryshme, në demokraci ne jemi të barabartë


Ne si qenie njerëzore, jemi të prirur që t'i zgjedhim gjërat që neve na pëlqejnë në bazë të kriterëve tona. Zgjedhjet e përditshme, janë shumë të rëndësishme për ne sepse ato tregojnë se si ne ndihemi dhe se çka ne pëlqejmë si në ushqim, si në veshje, apo edhe në kohën gjatë së cilës ne dëshirojmë të argëtohemi. Edhe për kohën e lirë, ne vendosim vetë se si ta kalojmë atë, duke lexuar, duke kënduar apo duke luajtur basketboll.


Gjatë punës sonë trajnerja e grupit tonë Bjondina, na pyeti se çfarë profesioni dëshirojmë të ushtrojmë në të ardhmen. Kjo pyetje na bëri të mendojmë edhe më

shumë, sepse edhe për këtë, jemi vetë ne ata të cilët vendosim se çka na përshtatet më së shumti, duke u bazuar në aftësitë tona.

Kur të rritemi, pra, kur të arrijmë moshën 18 vjeçare, ne do të marrim pjesë edhe në procesin zgjedhor. Ky proces, zhvillohet në shtetet demokratike, ku qytetarët kanë mundësi të votojnë për përfaqësuesit e tyre.

Të marrësh pjesë në procesin zgjedhor, është shumë e rëndësishme për neve si individë, por edhe për shtetin tonë. Një veprim i tillë na bën neve të jemi qytetarë aktiv sepse kështu ne kontribuojmë në ndërtimin dhe zhvillimin e shtetit tonë. Mos i harroni fjalët tona.





IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Pavarësia“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-3
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë